



10 - 17 TETOR / OCTOBER

21

Atlas of transitions 2

Shenjat

Signs

SKA

MIPA

FESTIVALI NERKOMBETAR I TEATRIT / INTERNATIONAL THEATRE FESTIVAL

ELBASAN 2019



BASHKIA
ELBASAN

Sponsor Gjeneral

abi AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

investo në optimizëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



Co-funded by the
Creative Europe Programme
of the European Union

**ATLAS OF
TRANSITIONS**



EMBASSY OF ROMANIA
in the Republic of Albania



Embassy of Hungary
Tirana







GLEDIAN LLATJA

***Kryetar i Bashkisë së qytetit të Elbasanit
President i Festivalit Nderkombëtar të Teatrit Bashkëkohor,
"SKAMPA 2019"***

***Mayor of Elbasan
President of the International Festival of Contemporary
Theatre "Skampa 2016"***

Eshtë kënaqësi për mua të përshëndes mbajtjen e Festivalit Ndërkombëtar Teatror "Skampa" në edicionin e tij të 21-të, këtu në Elbasan, ku lartësohen vlerat njerëzore përmes artit.

Ky festival, tashmë është bërë pjesë vokative e trashëgimisë sonë të re kulturore, si një event i pritshëm në dobi të audiencave dhe komunitetit teatror, jo vetëm për qytetin tonë artdashës por edhe më gjerë. Përpos rëndësisë që festivali "Skampa" ka në konsolidimin e përvojave krijuese, konfirmimin e vlerave dhe rrymave, që vënë në lëvizje teatrin sot, përmes shkëmbimit të kulturave, eksperiencave dhe tendencave artistike, ai luan gjithashtu një rol të madh në zbulimin e akumulimeve historike e kulturore, si dhe ndarjen e përvojës së Elbasanit dhe vendit tonë me botën.

Ndaj, jam i vendosur për të mbështetur këtë event, i cili, padyshim, ndikon në rritjen e cilësisë së jetës qytetare, por që njëkohësisht shërben edhe si një mundësi e shkëlqyer në krijimin e një identiteti unik multikulturor, që e shndërron Elbasanin, përgjatë kësaj feste ndërkombëtare teatrore, në një kryeqytet të kulturës.

Eshtë nder për mua, si Kryetar Bashkie, t'i uroj mirëseardhjen artisteve të ardhur nga Azerbajxhani, Hungaria, Italia, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania, SHBA, Kosova dhe qytete të tjera shqiptare.

It is my pleasure to welcome the opening of 21st edition of Skampa International Theatre Festival, here in Elbasan, where human values are glorified through art.

This festival has already become a vocative part of our new cultural heritage, as an expected event for the benefit of audiences and the theatre community, for our aesthete city and beyond.

In addition to the importance that Skampa Festival has in consolidating creative experiences, affirming values and artistic currents, that put theatre in motion today, through the exchange of cultures, experiences and artistic trends, it also plays a major role in discovering historical and cultural accumulations, as well as sharing the experience of Elbasan City and Albania with the world.

Therefore, I am determined to support this event, which definitely contributes to enhancing the quality of civil life, but at the same time serve as an excellent opportunity to create a unique multicultural identity, that transforms Elbasan in a capital of culture. It is my honour, as Mayor, to welcome artists from Azerbaijan, Hungary, Italy, Northern Macedonia, Poland, Romania, USA, Kosovo and other Albanian cities.

ADONIS FILIPI

Drejtor Artistik i Festivalit 'Skampa
Artistic Director of Festival Skampa



Teatri, me natyrën diakronike të ideve dhe efektin e tij të fuqishëm, përmes këndvështrimit bashkëkohor të artistëve të teatrit dhe kërkimit estetik vazhdon të na afrojë më pranë njëri-tjetrit edhe sot, duke hapur kështu shtigje të reja, nga shprehjet krijuese në përcimin e së vërtetës.

Horizontet janë të mjegullta, distancat po afrohen, aty, ku historia e fundit ka ekspozuar tragjedi bashkëkohore; ato kanë dëshmuar se jeta e tyre po kthehet kokëposhtë pa ndonjë shkak të dukshëm. Këta njerëz janë këtu. Ata takohen dhe bisedojnë në teatrin bashkëkohor. Ata kërkojnë përgjigje. Ata simpatizojnë njerëzit në sfida, për një jetë më të mirë, një sens drejtësie.

Koncepti i festivalit Skampa nuk ka ndryshuar deri më sot. Ai vazhdon të jetë i hapur për të gjitha llojet e alternativave të reja teatrore, duke kapërcyer kufijtë e njohur, duke eksploruar dhe frymëzuar artistë që janë të gatshëm të sfidojnë.

Theatre, with its diachronic nature of ideas and its powerful effect, through the contemporary outlook of theatre artists and aesthetic research continues to bring us closer to one another today, thus opening new paths from creative expressions in conveying the truth.

The horizons are misty, distances are approaching, where recent history has exposed contemporary tragedies; they have testified that their lives are turning upside down without any apparent cause. These people are here. They meet and converse in contemporary theater. They look for answers. They sympathize with people in challenges, for a better life, a sense of justice.

The concept of the Skampa festival has not changed to this day. It continues to be open to all kinds of new theatre alternatives, overcoming familiar boundaries, exploring and inspiring artists who are ready to challenge.

PROGRAM

10 - 17 TETOR / OCTOBER 2019

10 / 10 / 2019

18:30 / CEREMONIA / OPENING CEREMONY

19:00 / TEATRI SKAMPA

“JASHTË BIE BORE “ / “IT’S SNOWING OUTSIDE“ VICENZO SALEME
REGJIA / DIRECTED : QËNDRIM RIJANI
TEATRI KOMBËTAR / N T - TETOVË,
MAQEDONIA E VERIUT / N.MACEDONIA

11 / 10 / 2019

10:30 / PRESS KONFERENCE

18:30 / TEATRI SKAMPA

“DUKE PRITUR GODON“ / “WAITING FOR GODOT“
SAMUEL BECKETT
REGJIA / DIRECTED : YOUNES VALIPOUR
TEATRI MUZIKAL I SHTETIT / STATE MUSICAL THEATER, BAKU
AZERBAJXHAN / AZERBAIJAN

20:00 / TEATRI SKAMPA

“RROKULL VETES “ / “RETURN OWNS “
IDEA & DREJTIMI ARTISTIK: ARTAN IBËRSHIMI
3 AT DANCE KOMPANI
SHQIPERI / ALBANIA

12 / 10 / 2019

12:30 / QENDRA E ARTIT LIBRAZHD

“DHOMAT E VETMISE“ / “THE ROOMS OF SOLITUDE“
AUTORI & REGJIA / DIRECTED : ROMANO FODDAI
TEATRO S’ARZA, SASARI
ITALI / ITALY

18:30 / TEATRI SKAMPA

“MARINA AND ULAY“ BY EDITH NEGULIC
MAIA MORGENSTERN & MARIUS BODOCHI, BUKURESHT,
RUMANI / ROMANIA

20:00 / REAL SCAMPIS

PRITJE / WELCOME BY MR. GLEDIAN LLATJA
KRYETARI I BASHKISE / MAYOR OF ELBASAN MUNICIPALITY

20:30 / REAL SCAMPIS

“UDHA E QUMËSHITIT“ / “THE MILKY WAY“
AUTOR & REGJIA / DIRECTED : ARMANDO BORA
TEATRI SKAMPA, ELBASAN,
SHQIPERI / ALBANIA

13 / 10 / 2019

19:00 / TEATRI SKAMPA

“A U G U S T “ BAZUAR / BASED ON E BRUNO SCHULZ
REGJIA / DIRECTED : ZOLTAN BALAZS
MALADYPE TEATËR, BUDAPEST
HUNGARI / HUNGARY

20:30 / TEATRI SKAMPA

“PETER EL ROJO, THE GORILLA “ BAZUAR/BASED
ON FRANC KAFKA
REGJIA / DIRECTED : CARLOS ESPINAL,
AMERIKA / AMERICA

10:30 / **MASTERCLASS** / TEATRI KOMBETAR (TURBINA)

MAIA MORGENSTERN

10:30 / TEATRI SKAMPA

“MAGJISTARI I OZ-IT“ “THE WIZARD OF OZ“ BY L. FRANK BAUM
REGJIA / DIRECTED BY HYSEN MULLAJONUZI

14 / 10 / 2019

10:00 EKSPOZITE / EXIBITION

“BEST FOCUS“ - ARBEN ALLIAJ
UNIVERSITETI “ A XHUVANI “ / T. SKAMPA
ELBASAN

12:30 / QENDRA E ARTIT PEQIN

“LULE DIELLI“ / “SUNFLOWER“
REGJIA / DIRECTED : ADONIS FILIPI & XHULJANO BRISKU
LAB. TEATER A.T.K.
SHQIPERI / ALBANIA

19:00 / TEATRI SKAMPA

“KLAN MAK BETH“ / “CLAN MACBETH “
BASED ON W SHAKESPEARE
REGJIA / DIRECTED: DANIELE SCATTINA
TEATRO DELLE OMBRE - ROMË,
ITALI / ITALY

15 / 10 / 2019

13:00 / TEATRI SKAMPA

“FABRIKA E KUKULLAVE“ “PUPPET FACTORY“ NGA MENTOR HALITI
REGJIA / DIRECTED: NASER SHATROLLI
TEATËR KLLAPA, PRISHTINË
KOSOVË

19:00 / TEATRI SKAMPA

“KAFSHËT“ / “ANIMALS“, PRZEMYSŁAW PILARSKI
REGJIA / DIRECTED : ALICJA BORKOWSKA
POWSZECHNY TEATËR, VARSHAV,
POLONI / POLOAND

16 / 10 / 2019

10:30 / PRESS KONFERENCE

12:30 / QENDRA E ARTIT LIBRAZHD

“LULE DIELLI“ / “SUNFLOWER“
REGJIA / DIRECTED: ADONIS FILIPI & XHULJANO BRISKU
LAB. TEATER A.T.K.
SHQIPERI / ALBANIA

19:00 / TEATRI SKAMPA

“NUK DËGJOJ / NUK SHIKOJ / NUK FLAS “
“DON’T HEAR, DON’T SEE, DON’T SPEAK“,
J .THEODOSIADIS
REGJIA DIRECTED: DONALD HASANI & VALDRIN ASANI
THEATRE COMPANY D .V .SH, TIRANË
SHQIPERI / ALBANIA

WORK - SHOP

10 / 10 / 2019 - 16 / 10 / 2019

10:00 / “TEATËR I TOLERANCES“ / “THEATRE OF TOLERANCE“
DREJTUAR / DIRECTED : ADONIS FILIPI
T. SKAMPA / K. VULLNETARII / ELBASAN

10:00 / “KAPJA E MOMENTIT “ / “GRABBING MOMENT“
DREJTUAR / DIRECTED : ZOLTAN BALAZS
METROPOL TEATER / METROPOL THEATRE
TIRANË



JASHTE BIE BORE / OUTDOORS, IT IS SNOWING

TEATRI KOMBETAR

NATIONAL THEATRE - TETOVË

VINCEZO SALEME / AUTOR / AUTHOR

QENDRIM RIJANI / REGJISORE / DIRECTOR

EDLIRA QYSHKA / KOSTUMET / COSTUMES DESIGNER

RUSHAN HAMIDI, BERZAT JAKUPI / NDRIÇIMI/ LIGHTING

"Jashtë bie borë", një psiko-dramë, e cila nëpërmjet komikespërpiqet të pasqyrojë jetën e përditshme ose realitetin ku jetojmë, marrëdhëniet familjare, veçanërisht në një kohë kur emigracioni është thajse në kulmin e tij dhe të gjithë kanë dikë në shtëpi, për të cilin duhet të kujdesen. Një shfaqje me tre personazhe tragjikomikë: A do të vazhdojnë të jetojnë në një shtëpi? A do shkojë gjithsecili në punën e vet? A do t'i japin fund jetës apo do jetojnë të lumtur së bashku? Autori e jep përgjigjen në një mënyrë të përsosur. Kufiri ndërmjet normales dhe anormales është vetëm një armë për të pasur pushtet.

CAST :

**TRIMOSH RAMADANI, PETRIT NEZIRI,
BLERIM ISMANI, MUZAFER ETEMI**

"It's snowing – outside", a psycho-drama that comically tends to reflect the everyday life or the reality we live in, family relationships, especially at a time when immigration is almost at its peak and everyone has someone at home who needs to take care of. A play with three tragicomic characters: Will they continue to live in the same house? Will everyone go on with their lives? Will they end their lives or live happily together? The author gives the answer in a fine way. The boundary between normal and abnormal is just a weapon for power.

DUKE PRITUR GODON / WAITING FOR GODOT

AZERBAIJAN STATE MUSICAL THEATRE
SAMUEL BECKETT / AUTHOR
YOUNES VALIPOUR / REGJISOR / DIRECTOR

FARAJ GARAYEV / COMPOSER
YOUNES VALIPOUR / SET DESIGNER
FAKHRADDIN ATAYEV / CHIEF CONDUCTOR
ZAKIR AGHAYEV & YELENA AGHAYEVA / CHOREOGRAPHERS

Të presësh përjetësisht...Është e para herë që kjo vepër do të shfaqet në formën e muzikalit, përmes pjesëve muzikore të ndërthurura me poezinë absurde. "Duke pritur Godon" do të përcillet nën tingujt e veprës së një prej udhëheqësve të muzikës avangarde të Azerbajxhanit, kompozitorit Faraj Karayev, të titulluar "Pritja...", e kompozuar në zhanrin e teatrit instrumental. Jeta është një pritje me shpresë. Është e pamundur të vritet shpresa dhe madje, edhe kur është e qartë për të gjithë se Godo nuk do të vijë kurrë, shpresa jeton brenda individit deri në frymën e fundit. Përgjatë historisë së njerëzimit, të gjithë ne jemi vazhdimisht në pritje për diçka dhe gjatë kësaj pritjeje ne kalojmë në përjetësi ose në pakohësi... E tillë është jeta, i tillë është absurditeti – një pritje e gjatë në një hapësirë të pakohë...

CAST ;

SHOVGI HUSEYNOV, AZIZAGHA AZIZOV
ALIMAMMAD NOVRUZOV, HUSEYN ALILI, HUSEYN NAGHIYEV

Waiting for timelessness ... Is the first time that it will be displayed on a musical theater scene, in musical images intertwined with the poetry of absurdity, in the work of one of the leaders of Azerbaijani avant-garde music composer Faraj Karayev's "Waiting .." , composed in the genre of instrumental theater. Life is an expectation. It is impossible to kill hope and even when it is clear to everyone that Godot will never come, hope lives on in a person until the last breath. Throughout the history of mankind, we are all constantly waiting for something and in this waiting we go into timelessness... Such is life, such is absurdity - waiting in a hall of timelessness...





RROKULL VETES / AROUND YOURSELF

**ARTAN IBERSHIMI / IDEA KONCEPTI DHE KOREOGRAFIA
IDEA CONCEPT AND CHOREOGRAPHY
IBRAHIM ZABZUNI / SKENOGRAF DHE KOSTUMOGRAF
SET & COSTUMES DESIGNER**

Një spektakël danci i stilit kontemporan me elemente teatrore, që i referohet trashëgimisë kulturore shqiptare, rrënjëve shqiptare, ADN-së shpirtërore, e cila, në çdo moment, orienton përkatësinë e prejardhjes sonë kulturore. Gjetja apo kërkimi i gjuhës shprehëse koreografike bazohet në ritmikën, koloritin, emocionin, si dhe ridimensionimin muzikor, që këto pjesë kanë përfutur.

**CAST:
VERONIKI CHATZOPOULOU,
MILIRJAN HORANLLIU, TRINGA SHALA
ERMAL LUSHA, ERSY YMERI, VALTER HANA**

A contemporary dance performance with theatrical elements, referring to Albanian cultural heritage, Albanian roots, spiritual DNA, which guides to our cultural background. Finding or searching of the expressive choreographic language is based on the rhythm, color, emotion, and musical resonance that this performance has acquired.

DHOMAT E VETMISE THE ROOMS OF SOLITUDE

TEATER S'ARZA, ITALI

ROMANO FODDAI / SKENARI / SCRIPT / DIRECTOR / REGJIA

FABIO LOI / SKENOGRAF / SET DESIGNER

ANTONELLA SCODINO / COSTUME DESIGNER

TONY GRANDI / LIGHTING DESIGN

Dy protagonistët, Stefano Petretto dhe Roberta Campagna, e ushqejnë publikun e interesuar me mendime dhe i bëjnë atij pyetje të rëndësishme: Sa mund të ndikojë frika në zgjedhjet e përditshme të jetës sonë? A mund ta paralizojë frika njeriun përpara një rreziku, qoftë ai real apo i supozuar? Shfaqja kërkon të përfaqësojë një metaforë të shkëlqyer, në të cilën përdorimi shoqëror i frikës bën që secili prej nesh të izolohet, pranë të tjerëve, duke krijuar kushte të përshtatshme për shkatërrimin e këtij qytetërimi si dhe të atyre që kemi njohur.

**CAST:
STEFANO PETRETTO
ROBERTA CAMPAGNA,
MARIA PAOLA DESSÌ / RECITING VOICE**

The events of the two protagonists, played by Stefano Petretto and Roberta Campagna, nourish the audience's fascinated with thoughts and ask them important questions: How much the fear can affect in the daily choices of our life?

Can fear come to paralyze man before danger, real or the presumed? The show wants to represent a great metaphor, in which the social use of fear causes each of us to isolate, close to others, creating the conditions for the destruction of this civilization as well as the others we have known.





MARINA AND ULAY

EDITH NEGULICI / AUTHOR / AUTOR
MAIA MORGENSTERN & MARIUS BODOCHI,
BUKURESHT / BUCAREST / RUMANI / ROMANIA

Me një kast të jashtëzakonshëm - Maia Morgenstern dhe Marius Bodochi - "Marina & Ulay" lartëson personalitetin shpërthyes të superyllit Marina Abramović, në një mitologji dramatike të krijimit artistik ekstrem dhe emocionues. Jeta dhe puna e saj janë shumë interesante. Përtej arritjeve të saj ambicioze, Marina guxon të ekspozojë plagët më të thella për dashurinë e jetës së saj. Së bashku me Ulay, Marina është gjithçka. Historia e dashurisë, gjendja shpirtërore artistike, risjellja në kujtesë disa prej shfaqjeve më me ndikim në histori, të Marina Abramović dhe Ulay, vjen në Festivalin Ndërkombëtar të Teatrit "Skampa".

Cila aktore mund ta shprehte më mirë forcën dhe shpirtin krijues të Marina Abramović, sesa Maia Morgenstern, që është edhe vetë një artiste e përsosur, një prani impulsive dhe një talent i jashtëzakonshëm i teatrit dhe kinematografisë rumune dhe ndërkombëtare?!

CAST:
MAIA MORGENSTERN
MARIUS BODOCHI

With an exceptional cast – MAIA MORGENSTERN and MARIUS BODOCHI – "Marina & Ulay" celebrates the overwhelming personality of the superstar Marina Abramović in a dramatic mythology of his extreme, exciting artistic creation. Her life and her work are fascinating. Beyond the most ambitious achievements, Marina dares to expose her deepest wounds and bleeds for the love of her life. Together with Ulay, Marina is everything. The love story, the artistic mood, the remembrance of some of the most influential artistic performances in history, of the Marina Abramović and Ulay is coming to Skampa International Theater Festival.

Which actress could better express the creative force and spirit of Marina Abramović than Maia Morgenstern, who is herself a perfect artist, an impetuous presence and exceptional talent of the Romanian and international theatre and film?

UDHA E QUMESHTIT / THE MILKY WAY

TEATRI SKAMPA / ELBASAN

ARMANDO BORA / AUTOR DHE REGJISOR AUTHOR & DIRECTOR

KLITON KAPAJ / PRODUCENT

ZAJMIRA QERAXHIU / KOSTUMET / COSTUMES

"Udha e qumështit", e ndërtuar mbi një histori tipike të vërtetë të shoqërisë nën diktaturë, kur një gjest banal shkakton pasoja të rënda për jetën e qenies njerëzore.

"Çfarë është në gjendje t'i bëjë njeriu –njeriut?"

33 Karaktere që vijnë përmes historisë dhe forcës interpretuese të aktores Eglja Ceno, të cilët kalojnë nga një personazh tek tjetri, brenda një kohe të shkurtër, duke sjellë për spektatorët situata të ndryshme, që e bëjnë këtë rol të ketë një shkallë të lartë vështirësie.

**CAST:
EGLANTINA CENO**

"Milky way "built on a typical true story of the society under dictatorship that deals with essence of human being and not with the dictatorship as phenomena, when a banal gesture causes severe consequences for the life of the human being.

"What is a man capable of doing to another man?"

33 Characters that come through the story and interpretation of actress Eglja Ceno, passing from one character to another within a short time, bringing to the spectator various situations that make this role a high degree of difficulty.





AUGUST

BAZUAR / BASED ON NOVEL BY BRUNO SCHULZ
ZOLTÁN BALÁZS / REGJIA / DIRECTOR
KATALIN BALÁZS / PRODUCTION MANAGER
SYLVIA HUSZÁR / CREATIVE PRODUCER
MALADYPE THEATRE BUDAPEST / HUNGARY

"August", nën regjinë e Zoltán Balázs, ka si origjinë thëniet e metafizikës së Schulz dhe elementet e filozofisë së tij. Nga imagjinata dhe emocionet krijuesetë njerëzimit është shndërruar në joverbalizëm. Shfaqja është bazuar në formulat matematikisht të sakta të lëvizjeve. Aktrimi është ndërtuar mbi lëvizjet, gjestet, pamjen dhe e çon audiencën drejt një dimension të ri, por duke përfshirë sërish elemente të së kaluarës, të pranishëm në botën tonë plot me nostalgji. Performanca, instiktive dhe dinamike, përçon ndjenja shumë të forta, përshtypje, ndjesi, në drejtim të audiencës dhe për më tepër, ajo rrezaton aq shumë energji, sa të shtyn në rrënjët e saj, pa marrë parasysh nëse je apo jo i njohur me veprat Bruno Schulz.

Zoltán Balázs është një mysafir i rregullt i festivaleve dhe teatrove në mbarëglobin. Ai ka vënë në skenë shfaqje të ndryshmenë SHBA, Francë, Gjermani, Slloveni, Sllovaki dhe Rumani.

CAST:
BRIGITTA DÖRY, BRIGITTA ERŐSS,
RÓBERT FEKETE, SIMON JÁGER, ANDREA LUKÁCS,
GÁSPÁR MESÉS, LILLA ZSENÁK

"The August", directed by Zoltán Balázs, derives from Schulz's metaphysics sentences and the elements of his philosophy. It was converted from the imagination and creative feelings of mankind into non verbalism. The performance is based on the mathematically precise formula of movements. The acting is built up on movements, gestures, looks and it leads the audience towards a new dimension, but still it comprises elements of the past, present in our world full of nostalgia. The performance, instinctive and dynamic, sometimes ritual as it is, conveys very strong feelings, impressions, sensations to the audience and what is more, it radiates so much energy that it propels you to our roots notwithstanding whether or not you are familiar with Bruno Schulz's oeuvre.

Zoltán Balázs is a regular guest at festivals and theatres around the globe. He directed in the United States, France, Germany, Slovenia, Slovakia and Romania as well.

PETER EL ROJO, THE GORILLA

CARLOS ESPINAL / AUTORI / AUTHOR
BAZUAR/ BASED IN FRANZ KAFKA
CARLOS ESPINAL / REGJISOR / DIRECTOR

Versioni skenik nga Carlos Espinal, frymëzuar nga historia e famshme e Franc Kafkës, "Rrëfim në një akademi" na shtyn më tej në imagjinatën tonë. Gorilla bëhet një njeri i qytetëruar, zëri dhe klithma e dëshpëruar ekujtdo, që është detyruar të emigrojë në tokë të huaj, duke mësuar rregullat e reja, për t'u ndjerë i pranuar në një shoqëri, që, në fakt, e pat refuzuar, vetëm sepse thjesht dukej ndryshe, apo vetëm për faktin që ishte "i huaj". Është zëri i emigrantit, që përcillet përmes zërit të një njeriu, i cili dikur ishte një gorillë. Ai na çon në një vend, ku, nëse nuk je si të tjerët, nuk do të pranohesh kurrë, një vend që kupton vetëm modelin e krijuar nga "mainstream" (besimi i përgjithshëm). Espinal na bën të ndiejmë problemet e një shoqërie të tredhur, paragjyqese, një shoqërie që nuk e toleron ndryshmin.

Kjo shfaqje është nominuar me çmimet ndërkombëtare "Soberano", "Regjisori më i mirë", "Aktori më i mirë i vitit", si dhe në qytetin e Nju Jork-ut, "Aktori më i mirë në një monolog", për HOLA Awards.

CAST: **CARLOS ESPINAL**

The stage version by Carlos Espinal, inspired by famous story by Franz Kafka, "Confession to an academy", takes us further in our imagination. The gorilla become a civilized man, the voice and desperate crying of anyone who has been forced to emigrate to foreign land, learning new rules to feel accepted in a society that in fact, already rejected him for apparently the only factor of simply looking different, or just for the mere fact of been a "foreigner". This is the immigrant's voice through the voice of a man who once was a gorilla. It takes us out to a place where if you're not like the others, you will never be accepted, a place that only understands the mold established by the "mainstream". Espinal makes us feel the troubles of a castrating and prejudiced society, a society that does not condone the different.

Nominated to the international awards "Soberano", "Best director", winner as "Best Actor of the Year and in the city of New York, "Best Actor in a single performance" for the HOLA Awards.





MAGJISTARI I OZ / THE WIZARD OF OZ

L. FRANK BAUM / AUTORI / AUTHOR
HYSEN MULLAJONUZI / REGJISOR / DIRECTOR
NELSON MULLA / ADOBTIMI SKENIK / STAGE ADAPTATION
NORTEN KUMI / KOSTUMET / COSTUME DESIGNER
KLODIAN SHAHINAJ / DEKORI / SET DESIGN

Kurajoja dhe altruizmi i protagonistes së vepres, Doroti dhe udhëtimi aventuresk i saj në përpjekjen për tu rikthyer në shtëpi, miqesia e vërtete që krijon gjatë udhëtimit të vështirë, me luanin, druvarin , dhe dordolecin, janë një mesazh kuptimplotë për fëmijet se me miqesi të vërtete vështirësitë kalojnë dhe mbërrijnë suksesin në jetë.

CAST:

**ANDIA DUSHKU, REZI XHAJA, ENIA HOXHA, FRENIS LALA,
ERIN BERBERI, MARIO ELEZI, HYQMET MEHALLA
DHE DHIMITER TOPUZI**

The protagonist's courage and altruism, Dorothy and her adventurous journey in the quest to return home, the true friendship she creates during the difficult journey, with the Lion, the Woodman, and the Scarecrow, are a meaningful message to children of friendliness. indeed the hardships pass and we achieve success in life.

LULE DIELLI / SUNFLOWER

LAB.TEATER A.T.K.

IDEA DHE KONCEPTI NGA ADONIS FILIPI

ADONIS FILIPI & XHULJANO BRISKU / REGJISOR/ DIRECTOR

Një endje e pafund e qënies njerëzore, deri në kufijtë e ekzistencës. Individë, grupe të ndryshme njerëzish, të cilët, pavarësisht prejardhjes së tyre, nga kultura të ndryshme përfaqësuese, ndajnë të njëjtën sfidë: ata janë të gatshëm të paguajnë frikën, ankthin, pasigurinë, diskriminimin, për një jetë më të qetë dhe më të mirë.

CAST:

XHULIANO BRISKU

ILIRDA BEJLERI

DONALD SHEHU

DAJANA NENAJ

AMRI HASANLLIU

EVIS SERANI

An endless meanders of the human being in the limits of existence. Individuals, different groups of people, who, regardless of their background, from different representational cultures, share the same challenge: they are willing to pay the fear, anxiety, insecurity, and discrimination for a more peaceful and better life.





KLAN MAKBETH / CLAN MACBETH

TEATRO DELLE OMBRE, ROME, ITALY
WILLIAM SHAKESPEARE / BAZUAR / BASED
DANIELE SCATTINA / REGJISOR / DIRECTOR
ALESSIO SORO / NDRICIMI / LIGHT DESIGNER

Shfaqja "Klan Macbeth", ka lindur si nevojë për të eksploruar thellësisht thelbin e ndjenjave njerëzore, mbi të gjitha, ato që i përkasin gjysmës së errët. Vendimi për të reduktuar këtë tragjedi vetëm në tre personazhe (Macbeth, Lady Macbeth dhe një Xhoker) buron nga besimi, se ka një nevojë në rritje për t'u përqëndruar te sinteza, pa humbur konceptin e rrëfimit epik.

CAST:
DANIELE SCATTINA / MACBETH
MARZIA TEDESCHI / LADY MACBETH
ROMEO CIRELLI / JOKER AND OTHERS

"Clan Macbeth", is born with the need to explore deeply the essence of the human feelings, above all the ones that belong to the dark half. The decision to reduce this tragedy to just three characters (Macbeth, Lady Macbeth and a Joker) stems from the belief that there is an increasing need to be focused in the synthesis without losing the atmosphere of the biggest epic.

FABRIKA E KUKULLAVE / PUPPET FACTORY

TEATER KLLAPA, KOSOVO
MENTOR HALITI AUTOR/AUTHOR
NASER SHATROLI / REGJISOR / DIRECTOR

DRINOR ZYMBERI / MUZIKA
AGRON BLAKQORI & ARTAN HASANI
SKENOGRAF / SET DESIGNERS
AR VESELAJ / KOSTUMET / COSTUMES DESIGNER

Kjo dramë ka si subjekt historinë e një drejtuesi të një fabrike lodrash, që prodhon kukulla. Një drejtuesi, sa komik, po aq tragjik, që për interesat mesquine e pragmatiste, me fuqinë që i jep ligji, kërkon që punetoret të bëhen marioneta për qëllimet e tij. Nje shfaqje shenjash të absurditetit, të ndërtuara mbi bazën e teatrit eksperimental.

CAST:
BUTRINT LUMI
RINA KRASNIQI
AMAR HAVZIJI

The drama has specifically called for the subject, The History of a President of a Puppet Factory, which produces puppets. A comic just as tragic president, that for the pragmatist interests, and the power that the law gives, requires to treat workers like puppets of his own accord. A constellation of absurdity built into the sense of Experimental Theater.





KAFSHËT / ANIMALS

PRZEMYSŁAW PILARSKI / AUTOR / AUTHOR
REGJIA / DIRECTED : ALICJA BORKOWSKA

PIOTR SZCZYGIELSKI / SET DESIGNER
RAY DICKATY / MUZIKA / MUSIC
MARIA PORZYC / VIZUAL / VISUALIZATION
MAGDALENA DUSZYŃSKA-ŁYSAK / PRODUCENT/ PRODUCER
POWSZECHNY TEATR, VARSHA / WARSAW
POLONI / POLAND

Një trup është shtrirë në plazh. Duket njerëzor por nuk është. Duket si kafshë por nuk është. Trupi po lëviz, nxjerr tinguj. Ne mundohemi të komunikojmë me të, duke përdorur gjuhën, gjestet, tingujt, rrëfimet. Ne mundohemi ta zbusim atë, ta bëjmë njerëzor. E drejtë, por çfarë do të thotë të jesh njerëzor? Ne kthehemi te origjina - dikur kishte specietë ndryshme njerëzore në Tokë. Si ndodhi që vetëm "Homo sapiens" ka mbijetuar? Si dhe pse "Homo sapiens" asgjësoi të gjitha speciet e ngjashme dhe nënshtroi qeniet e tjera të gjalla?

Kjo pjesë është pjesa e parë e trilogjisë së dramës "Kafshët - Njerëzit - Zotat", e shkruar nga Strefa Wolnościowa. Shfaqja është realizuar në kuadër të projektit ndërkombëtar Atlas of Transitions, Gjeografi të reja për një Evropë ndërkulturore. Bashkëfinancuar nga Programi Kreativ Evropian i Bashkimit Evropian.

CAST:
MAMADOU GÓO BÂ, VERANIKA LOS,
JUSTYNA LASKOWSKA-OTWINOWSKA,
STEPHANE RUTTEN, ŁUKASZ WÓJCICKI

A body is lying on the beach. Seems human but isn't. Seems animal but isn't. The body is moving, making sounds. We're trying to establish communication, using language, gestures, sounds, stories. We're trying to tame it, make it human. Right, but what does it mean to be human? We go back to the source – there used to be several human species on Earth. How did it happen that only Homo sapiens has survived? How and why did Homo sapiens annihilate all the sister species and subjugate the world of other living beings? This play is the first part of the "Animals-Humans-Gods" drama trilogy ,by Strefa Wolnościowa.

Performance is organized in range of the international project Atlas of Transitions. New geographies for a cross-cultural Europe. Co-funded by the Creative Europe Programme of the European Union.

NUK DEGJOJ, NUK SHIKOJ, NUK FLAS I DON'T HEAR, I DON'T SEE, I DON'T TALK

**KOMPANIA TEATRORE D.V.SH - TIRANE
DONARD HASANI & VALDRIN ASANI / REGJIA / DIRECTED
SHEGUSHE BEBETI / PRODUCER
BEQO NANAJ / SKENOGRAF / SET DESIGNER
SOKOL MARSI / MUZIKA / MUSIC**

Komedia "Nuk dëgjoj, nuk shikoj, nuk flas" është një miks ndjesish e mendimesh, e shkruar nga autori grek Yorgos Theodosiadis dhe e sjellë në skenën shqiptare nga producentja Shegushe Bebeti, me konceptin regjisorial të Donard Hasanit e Valdrin Asanit. Është absurditeti që nxit dialogë e lojë skenike shumë interesante, që shkakton batuta e të qeshura pafund, nën lojën e aktorëve Ervin Bejleri, Romir Zalla, Alert Çeloaliaj e Jorida Meta.

**CAST:
ROMIR ZALLA, VIN BEJLERI
ALERT CELOALIAJ, JORIDA META**

The comedy "I Don't Hear, I Don't See, I Don't Speak" is a mix of emotions and thoughts that evoke this work, written by Greek author Yorgos Theodosiadis, and brought to the Albanian stage by producer Shegushe Bebeti, directed by Donard Hasan and Valdrin Hasani. It is absurdity that drives the dialogue and the very interesting stage play, that causes endless jokes and laughter under its cast: Ervin Bejleri, Romir Zalla, Alert Çelaliaj and Jorida Meta.





EKSPozITE

EXIBITION

14.10.2019 10.00

UNIVERSITY "A.XHUVANI", ELBASAN

FOKUS
INTERNATIONAL PHOTOGRAPHY AWARD

FOKUS

ARBEN ALLIAJ / KURATOR / CURATOR

Fokus , një aktivitet ndërkombëtar kushtuar fotografisë artistike dhe vlerave që ajo përcjell në fushën e madhe të arteve pamore inspiruar në fotografinë Shqiptare por dhe duke ndjekur dhe eksperiencat ndërkombëtare.

Focus, an international event dedicated to artistic photography, is included as a mosaic at the Skampa Festival '2019 International Festival. An exhibition inspired by Albanian photography but also by international experiences.

WORKSHOP



“TEATRI I TOLERANCËS” / “THEATRE OF TOLERANCE”

BY ADONIS FILIPI

10-16 T.SKAMPA & K.VULLNETARI

Qëllimi kryesor i punës është të ofrojë një kuptim dhe kënaqësi të traditave të ndryshme dhe përvojave të kombinuara me gjuhë dhe teknika të ndryshme; bazuar në proceset pjesëmarrëse të njerëzve që janë të interesuar të përfshijnë veten e tyre në teatër artist të ri, jo profesionistë, njerëz që vijnë nga backgrounde me kultura të ndryshme. Komunikimi, përvoja e përbashkët, është në zemër të punës. Punëtorja, e bazuar në fushën e vlerave njerëzore si emigracioni, refugjatët. Fokusi i kësaj punëtorie përfshiu tema të tilla si eksplorimi dhe gjetja e lidhjeve bashkëkohore - krijimi i jetës përmes veprimit skenik, (larmi teknikash fizike dhe improvizuese).

The main aim of work is to offer an understanding and enjoyment of different traditions and experiences combines with different languages and techniques ;. based on the participatory processes of the people that are interested to involve themselves in theatre young artist ,non-professionals,people that come from different cultural backgrounds Communication, the shared experience, is at the heart of work.

The Workshop, based on the field of human values like emigration, refugees. The focus of this workshop included topics such as the exploration and the finding of contemporary connections – the creation of life through scenic action,(variety of physical and improvisational techniques).

THE GOLD BUG METHOD

BY ZOLTÁN BALÁZS

10:30 - 14 TETOR / OCT - TEATRI METROPLIT, TIRANA

Qëllimi i workshop-it të Zoltán Balázs - i krijuar në mënyrë unike për aktorët e trainimit - është të zhvillojë teknikat në lëvizje, dialog dhe forcimin e ndjenjës së trupit përmes vetë-ekzaminimit. Metoda Gold Bug u quajt pas veprës së Edgar Allan Poe, personazhet kryesore të të cilit i arrijnë qëllimet e tyre falë aftësive të tyre analitike dhe vlerësuese dhe njohurive të vërteta. Tema kryesore e seminarit është: “Grabbing moment” - kuptimi dhe shfrytëzimi i mundësive të momentit në skenë.

The aim of Zoltán Balázs's workshop - uniquely developed for training actors - is to develop the techniques for moving, dialogue and enhance the sense of body through self-examination. The Gold Bug method was named after the work of Edgar Allan Poe, whose main characters reach their goals thanks to their analytical and evaluative skills and real knowledge. Workshop main topic is: „Grabbing the moment” - understanding and using the opportunities of the moment on the stage.

MASTERCLASS

MAIA MORGENSTERN

11:00 - 13 TETOR / OCT - NT / T KOMBETAR (TURBINA), TIRANA

STAF / STAFF

Adonis Filipi	Drejtor Artistik i Festivalit/Artistic Director of Festival 'Skampa
Kliton Kapaj	Drejtor i Qëndrës Artit / Director of Art Center, Elbasan
Arian Çala	Drejtor Ekzekutiv / Shoqata Tjeter Vizion
Geris Filipi	As. Drejtor i Festivalit / As. Director of Festival
Blendi Gremi	Kordinatore/ Coordinator of Festivalit
Diana Kasaj	Kordinatore/ Coordinator of Festivalit
Klejda Plangarica	Media
Elona Mamo	Coordinator of Festivalit Kordinatore
Zhaneta Ruçaj	Bashkpuntore /Collaborators of Festival
Brunilda Kola	Marketing
Saimir Ahmeti	Bashkpuntor / Collaborators of Festival
Cen Mullajonuz	Bashkpuntor / Collaborators of Festival
Doru Motoc	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Romania)
Renato Sotiriadhi	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Russia)
Romano Foddai	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Italy)
Robert Germay	Bashkpuntor / Collaborators of Festival (Belgium)
Klodian Shahinaj	Inspektor skene / Stage manager
Helidon Gremi	Ndricimi / Lighting Technician
Met Çera	Zëri /Sound Technician



SKAMPA

CONTEMPORARY INTERNATIONAL
THEATER FESTIVAL

